



Komuna e Klinës

Drejtoria e Administratës

02Nr. 031-11808 2020

Klinë, dt.05.06.2020

Në përputhje me dispozitat e nenit 75 dhe 91 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 të dt.07.04.2010, pas autorizimit gojor nga ana e kryetarit të komunës për ndërmarrjen e veprimeve lidhur me organizimin e punëve brenda institucionit, më dt.05.06.2020, Drejtori i Drejtorisë së Administratës, bie këtë:

URDHËRESË

Për evidentimin e palëve që hyjnë në objektin e Komunës së Klinës

1. URDHËROHET, Shërbimi teknik i Komunës së Klinës- sigurimi, që të ndaloj dhe evidentoj të gjitha palët dhe personat që hyjnë në objektin e Komunës së Klinës, me përjashtim të punëtorëve të administratës komunale.
2. Më rastin e hyrjes në objektin komunal të gjitha palët dhe personat tjerë të identifikohen nga shërbimi kompetent, si dhe të regjistrohen të dhënat e tyre personale në regjistër- librin e evidentimeve.
3. OBLIGOHET, shërbimi i sigurimit që fillimisht t'a kontaktoj zyrtarin apo udhëheqësin më të cilin ka pune pala më pastaj palën t'a lejoj të vazhdon tutje.
4. Kjo urdhëresë do të filloj së zbatuari menjëherë të cilën është i obliguar ta zbatoj shërbimi teknik- siguri i komunës së Klinës.
5. Ne rast të moszbatimit të saj do të ndërmerren masa sanksionuese në përputhje me autorizimet ligjore.
6. Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj urdhëresë e bën Drejtoria e Administratës së Komunës së Klinës në bashkëpunim me organet tjera ndihmese.

Të njoftohen:

- Kryetari,
- Shërbimi teknik- sigurimi;
- Arkivi.

Drejtori,
Binak Sylaj

